

## Titulli i lëndës: BAZAT E PROJEKTIMIT 1

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Arkitekturës		
Titulli i lëndës:	Bazat e Projektimit 1		
Niveli:	BA		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	1/SEM 1		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Kreditë ECTS:	6		
Koha / Vendi:	Sipas orarit të shpallur		
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr. Rozafa Basha		
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:Rozafa.basha@uni-pr.edu">Rozafa.basha@uni-pr.edu</a>		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Ky kurs synon t'i njoftojë studentët e arkitekturës me përkufizimet themelore të formës dhe hapësirës dhe parimeve që do t'i ndihmojnë për të vënë rend në ambientin e ndërtuar. Në këtë kurs forma dhe hapësira nuk prezantohen si caqe por si mjete për të zgjidhur problemet, që kanë të bëjnë me konditat e funksionit, qëllimit, dhe kontekstit.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kursi ka për qëllim t'iu paraqes studentëve një definicion të thjeshtësuar të arkitekturës, duke madhështuar aspektin vizual të balansit arkitektonik, dhe për t'i njoftuar studentët me të gjitha parimet vizuale të dizajnit duke përdorur dorën si mënyrë të vetme të prezantimit.		
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	<p>Në përfundim të kursit, studenti:-</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përdor ligjshmëritë e proporcioneve dhe të masës si mjete të shprehurit arkitektonik</li> <li>-Përkufizon atributet themelore të formës dhe hapësirës dhe të parimeve që do t'i ndihmojnë për të vënë rend në mjedisin e ndërtuar.</li> <li>-Shqyrton komponentet arkitekturale në vepra arkitekturale të tjera si parakusht për nisjen e veprimtarisë vetanake.</li> <li>-Zbaton ligjshmëritë e teorive të harmonisë së ngjyrave në kompozicione arkitektonike;</li> <li>-Vizat kompozicione harmonike arkitektonike përmes zbatimit të ligjshmërive dhe karakteristikat pamore të formave dhe hapësirës.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	0.2	10	2

Konsultime me mësimdhënësin			
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	2	2
Detyrë shtëpie	3	10	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>157~6 ECTS</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërimi ex-catedra si dhe diskutimi i temave që ndërlidhen me ligjëratat në mënyrë interaktive me studentë. Ushtrimet zhvillohen përmes detyrave tematike grafike javore që punohen dhe diskutohen në klasë, si dhe detyrave grafike shtëpiake. Detyrat grafike do të jenë: individuale dhe grupore.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi nga prezenca - 5%; Punimet individuale grafike - 40%; Punimi/et grupor/e grafik/e - 20%; Kolokuimi 1 dhe 2 - 30%; Seminar i shkurtër - 5%. Provimi me shkrim mbahet për studentët që nuk i kalojnë kolokuimet.		
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.R. Basha, prezantimet e përditësuara dhe përmbledhja e ligjëratave, që i shpërndahen studentëve çdo javë.</li> <li>2.F. D. K. Ching, 'Architecture, Form, Space and Order' –Wiley; 5th edition, 2023.</li> <li>3.S. Unwin, Exercises in Architecture: Learning to Think as an Architect 2nd Edition, Routledge 2022</li> <li>4.S. E. Rasmussen, 'Experiencing Architecture' - MIT Press, 1964</li> <li>5.J. Itten, The Elements of Color, Van Nostrand Reinhold Company, 1970</li> <li>6.J. Albers, Interaction of Color, Yale University Press, 2013</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. R. McCarter, J. Pallasma, 'Understanding Architecture', Phaidon Press, 2012</li> <li>2. S. Holl, J. Pallasmaa, A. Perez-Gomez: 'Questions of perception – phenomenology of architecture', -- William Stout San Francisco 2006</li> <li>3. J. Pallasma. 'The Eyes of the Skin: Architecture and the Senses', John Wiley &amp; Sons; 2nd edition, 2005</li> <li>4. S.Unwin, Analysing Architecture, Routledge, 2014</li> </ol>		
<b>Hartimi i planit mësimor</b>			
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>		
<b>Java 1:</b>	<i>HYRJE NË LËNDËN BAZAT E PROJEKTIMIT 1</i>		
<b>Java 2:</b>	<i>PERCEPTIMI PAMOR</i>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi; Procesi i seleksionimit pamor.</li> <li>- Perceptimi i distancave.</li> </ul>
<b>Java 3:</b>	<p><b>PERCEPTIMI PAMOR</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perceptimi i formave.</li> <li>- Procesi i organizimit të formave në rrafsh dhe hapësirë (parimet Gestalt),</li> <li>- Iluzioni optik dhe rëndësia e tij në arkitekturë</li> </ul>
<b>Java 4:</b>	<p><b>NGJYRAT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fizika e ngjyrave</li> <li>- Ndiqimet themelore të ngjyrave</li> </ul>
<b>Java 5:</b>	<p><b>NGJYRAT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemet e identifikimit dhe të shënimit të ngjyrave.</li> </ul>
<b>Java 6:</b>	<p><b>NGJYRAT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dinamika e ngjyrave - Kontrasti simultan.</li> <li>- Ndikimi i ngjyrës në formë.</li> <li>- Harmonia e ngjyrave</li> <li>- Aplikimi i ngjyrës në arkitekturë - në ndërtesa, në hapësirë publike dhe në enterier</li> </ul>
<b>Java 7:</b>	<p><b>RITMI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i ritmit në arkitekturë;</li> <li>- Mënyrat e formimit të ritmit në arkitekturë me anë të elementeve konstruktive, funksionale dhe dekorative.</li> <li>- Llojet e ritmit në arkitekturë.</li> </ul>
<b>Java 8:</b>	<p><b>MASA NË ARKITEKTURË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i masës.</li> <li>- Interpretimi i masës (zbatimi i çelësit).</li> <li>- Llojet e masës</li> </ul>
<b>Java 9:</b>	<p><b>Vlerësimi intermediar i njohurisë së nxënë përmes <b>Kolokiumit të parë</b></b></p>
<b>Java 10:</b>	<p><b>PROPORCIONET NË ARKITEKTURË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i proporcioneve në arkitekturë.</li> <li>- Teoritë dhe tipet e ndryshme të proporcioneve në arkitekturë.</li> </ul>
<b>Java 11:</b>	<p><b>SEKUENCAT NË ARKITEKTURË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekuencat në arkitekturë.</li> <li>- Dozimi i interesit dhe klimaksi.</li> <li>- Llojet e sekuencave (formale dhe joformale)</li> </ul>
<b>Java 12:</b>	<p><b>LËVIZJA NË ARKITEKTURË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përjetimi i objektit arkitektural gjatë lëvizjes nëpër objekt dhe përreth tij.</li> </ul>
<b>Java 13:</b>	<p><b>KARAKTERI NË ARKITEKTURË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i karakterit të objektit arkitektural;</li> <li>- Mënyrat e shprehjes adekuate e funksionit dhe e domethënies së objektit;</li> <li>- Mënyrat e shprehjes së porosisë ideore të arkitektit – krijues.</li> </ul>
<b>Java 14:</b>	<p><b>TEKSTURA DHE DRITA NË ARKITEKTURË</b></p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Tipet e teksturave</i></li> <li>- <i>Materiali dhe tekstura</i></li> <li>- <i>Drita në arkitekturë</i></li> </ul>
<b>Java 15:</b>	<i>Vlerësimi i dytë semestral i njohurisë së nxënë përmes <b>Kolokiumit të dytë.</b></i>

#### **Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

*Rregullat e mirësjelljes:*

- *Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Me më shumë se 3 mungesa të arsyeshme apo të paarsyeshme, studentit nuk i lejohet vazhdimi i lëndës në vitin përkatës akademik dhe detyrohet që ta përsëris lëndën në vitin e ardhshëm akademik.*
- *Mbajtja e qetësisë në mësim*
- *Ndalja e telefonave celularë*
- *Hyrja në sallë të mësimit me kohë*

**Shënim |** *Të drejtë për t'iu nënshtruar provimit nga lënda BAZAT E PROJEKTIMIT 1 kanë studentët të cilët i kanë dorëzuar me kohë të gjitha detyrat grafike në afatet e përcaktuara nga mësimdhënësja; studentët të cilëve të gjitha punimet grafike të punuara gjatë semestrit iu vlerësohen me notë pozitive (6-10), si dhe studentët të cilët nuk kanë më shumë se tre mungesa të arsyeshme/ të paarsyeshme në ligjërata ose ushtrime.*